

NË EMER TË POPULLIT

17. 07. 17

GJYKATATHEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Bytyqi dhe zyrtare ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit, [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.2456/11 të dt. 23.05.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datë 20.04.2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, përfaqësuesit juridik të DBP-së, Nesret Ademi si dhe të akuzuarit [REDAKTUAR], mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: [REDAKTUAR] i lindur me datë [REDAKTUAR] me vendbanim në Fshati [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] i nënes [REDAKTUAR] i gjinisë [REDAKTUAR] i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 20.11.2011, rreth orës 16:00 në pyllin publik, në menaxhimin e Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në rajonin ekonomiko-pyjor Neredime-Jezercë, në vendin e quajtur "paralelja 47", me qëllim vjedhje ka prerë 14 cope trungje të ahut të njomë, me diametër 20-40 cm. me gjatësi prej 18 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 8.68 m3. në vlerë prej 1171.80 Euro dhe i ka transportuar me traktor.

me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 të KPK-së

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

GJYKON

- *DËNIM ME GJOBË, në lartësi prej 300€ /treqind euro/, të cilin gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.*
- *Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 Euro do të vuaj 1 /një/ ditë burgimi.*
- *Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore – juridike, të kompensoj dëmin DBP-së në Ferizaj, në shumën e përgjithshme prej 1171.80 €, në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.*
- *Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30 €, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.*

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP.nr.2456/11 të dt. 23.05.2012, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fsh.

■■■■■, për veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 285 par. 2 të KPK-së, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 20.04.17, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuarit ■■■■■ në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: se nuk e pranojë fajësinë për veprën penale të cilën më vihet në barrë.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajsin për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paqartësinë e provave dhe pas vlersimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprocikisht njëri me tjetrin, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimit:

Gjykata bëri zbatimin e provave, dëgjoj dëshmitarin ■■■■■ – rojtar pylli, lexoj fletëparaqitjen e rojës së pyllit nr. datari 2271/2011 dt. 30.11.2012, procesverbalin e eksperteve të pylltarisë mbi vlerësimin e dëmit nr. 900/2011 dt. 20.08.2014, si dhe fotografit të cilat janë bërë në vendin e ngjarjes, duke çmuar dhe vlerësuar provat e nxjerra një nga një dhe së bashku, gjykata vërtetoj këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri ■■■■■ me datën 20.11.2011, rreth orës 16:00 në pyllin publik, në menaxhimin e Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në rajonin ekonomiko-pyjor Neredime-Jezercë, në vendin e quajtur "paralelja 47", me qëllim vjedhje ka prerë 14 cope trungje të ahut të njomë, me diametër 20-40 cm, me gjatësi prej 18 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 8.68 m3, në vlerë prej 1171.80 Euro dhe i ka transportuar me traktor.

Këtë gjendje të fakteve si më lart gjykata e vërtetoj nga dëgjimi i dëshmitarit - Roja e Pyllit Ramadan Ukzmajli, i cili në mënyrë bindëse dhe objektive dëshmoj për faktet relevante, se të akuzuarit e ka takuar me datën 20.11.2011 në orën 16:00, në rajonin ekonomike-pyjor në Fsh.

Neredime – Jezerc, në vendin e quajtur “paralelja 47”, aty i ka prerë 14 copë trungje, me diametër 20-40 cm, me gjatësi prej 18 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 8.68 m3. Unë personalisht e kam parë duke i prerë lisat, të njëjtët lisa i ka ngarkuar në traktor, kam bërë edhe fotografitë dhe matjen e drunjeve.

Dëshmitari me tutje sqaron se në Rajonin Rkonomiko Pyjore Neredime-Jezerc ka edhe prona private, mirëpo paralelja e 47 është e gjitha pronë shtetërore. Unë kam qene i vetëm kur e kam takuar [REDAKTUAR], ne atë vend ka pasur edhe dëmtues të tjerë të pyjeve, drutë [REDAKTUAR] i ka marrë dhe i dërguar në shtëpi, fotografitë i kam bërë në vend të ngjarjes, drutë disa i ka pasur të gjata disa të shkurtra. Gjykata i fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit-pylltarit.

Sa më sipër, u provua ne gjykimin e çështjes me provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, nder të cilat theksohen:

- procesverbalin i komisionit të eksperteve të pylltarisë mbi vlerësimin e dëmit nr. 309/2014 dt. 20.08.2014;
- fletëparaqitjen e rojës së pyllit nr. ditari nr. 900/2011 dt. 20.08.2014;
- fotografitë të cilat janë bërë në vendin e ngjarjes.

Gjykata, çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] kinse nuk ka prerë drunjë ne paralelen 47 se nuk e din as ku gjendet paralelja 74, gjoja se i ka prerë në pronën private respektivish në malin tij, në vitit 2011 Muaj nëntor ka qenë ne mal me traktor, arsyeja pse ka shkuar ka qenë për të marre dru për nevoja personale dhe familjave dhe keto dru i ka marre në pronën private të tij edhe perkunder faktit se nuk ka patur leje nga Komuna pasi nuk e ka ditur se lëshojnë leje per prerje te druve edhe per prone private. I pandehuri më tute shton se rojen e pyllit e kam takuar 70-80 metra afër shtëpisë time, unë kam qënë duke vozitur rrugës kur me ka takuar roja e pyllit, pronën private nga shtëpia ku unë jetojë e kam rreth 3 km. kam 2 apo 3 hektar sakte nuk e di, prona ime nuk kufizohet me asnjë pronë shtetërore pasi që e gjitha ajo pjesë është e fshatarve, por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti se nga dëshmia e

dëshmitarit-pylltarit [REDACTED] u vërtetua pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt se të akuzuarin e ka takuar në pyllin shoqëror publik në territorin e fshatit Neredime-Jezercë respektivisht në paralelen e 47, me qëllim vjedhje ka prerë 14 cope trungje të ahut të njomë, me diametër 20-40 cm, me gjatësi prej 18 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 8.68 m3, dhe i ka transportuar me traktor, dëshmitari në prezencën e të akuzuarit në seancën kryesore ka identifikuar të pandehurin, ka vërtetuar faktet relevante dhe atë kohën, datën dhe vendin ku e ka zënë të akuzuarit duke pre drut, mjetin me të cilin kanë pre dru pa leje, dhe mjetin me të cilin ka bartur drutë e prerë pa leje, i akuzuarit nuk ishte në gjendje që me pyetje dhe nënpyetje të demantojnë dëshminë e dëshmitarit.

Duke vërtetuar këtë gjendje faktike gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 të KPK-së, andaj gjykata e shpalli fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 300 Euro, i cili duhet ta paguaj në afat prej 15 diteve nga dita kur aktgjykimi të merr formës së prerë, njëkohësisht gjykata obligon të akuzuarit që të paguajnë në emër të kompensimit të dëmit DBP-së – zyra Regjionale në Ferizaj, pasi që i pandehuri me veprimet e kundërligjshme me qëllim vjedhje ka prerë dru në kubaturë e përgjithshme prej 6.68 meter kubë nga procesverbali i komisionit 309/2014 dt. 20.08.2014, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 1171.80 €.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata pati parasysh faktin se nuk ka dëshmi për se është gjykuar me vendim të formës së prerë, është mbajtës i familjes, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoj shkallen e përgjegjësisë penale për të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin si në diapozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënime të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe me autoret të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen

(preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).


Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore – juridike, të kompensoj dëmin DBP-së në Ferizaj, në shumën e përgjithshme prej 1171.80 €, në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prere.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30/tridhjetë/€ në afat prej 30 ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurve.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.275/13, me datë 20.04.2017.

Zyrtare ligjore
Kadishe Shabani



Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.